



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

PROCESVERBAL

Tiranë, më 18.2.2022, ora 11:30

Drejton mbledhjen:

Mimi Kodheli - kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të komisionit të datave 13 dhjetor 2021 dhe 19 janar 2022.
2. Miratimi i Kalendarit të punës së komisionit për periudhën 7 – 24 shkurt 2022.
3. Seancë dëgjimore me zonjën Eglantina Gjermani, kandidate për Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqiptotë i Republikës së Shqipërisë pranë Misionit të OSBE-së dhe Organizatave Ndërkombëtare në Vjenë, rezident.

Marrin pjesë:

Mimi Kodheli, Etjen Xhafaj, Petro Koçi, Besion Ajazi, Benet Beci, Tomorr Alizoti, Hatixhe Konomi, Klodiana Spahiu, Lavdrim Krrashi, Vangjel Dule, Taulant Balla, Tritan Shehu, Ilirjan Pendavinji dhe Shpëtim Idrizi.

Mungojnë:

Blendi Klosi, Grida Duma, Alqi Bllako, Belind Këlliçi, Kreshnik Çollaku dhe Greta Bardeli.

Të ftuar:

Armand Skapi - Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë për Europën dhe Punën e Jashtme

Eglantina Gjermani - Kandidate për Ambasadore

HAPET MBLEDHJA

Mimi Kodheli – Mirëdita!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Politikën e Jashtme, datë 18.2.2022. Në rendin e ditës së mbledhjes së sotme kemi miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të komisionit të datave 13 dhjetor 2021 dhe 19 janar 2022, miratimin e kalendarit të punës së komisionit për periudhën 7 – 25 shkurt 2022, si dhe seancën dëgjimore me zonjën Eglantina Gjermani, kandidate për Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë i Republikës së Shqipërisë pranë Misionit të OSBE-së dhe Organizatave Ndërkombëtare në Vjenë, rezident. Të ftuar kemi kandidaten për ambasadore, kolegen tonë, zonjën Gjermani, dhe sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme, zotin Skapi, të cilëve u uroj mirëseardhjen!

Pa humbur kohë fillojmë me miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të komisionit të datave 13 dhjetor 2021 dhe 19 janar 2022. Shikoj që nuk ka kundërshtime, ndaj i konsideroj të miratuara.

Vazhdojmë me kalendarin e punës së komisionit për periudhën 7-25 shkurt. Ne i kemi kaluar të gjitha projektligjet që kanë ardhur në komision, ndaj jemi në rregull me kalendarin.

Vazhdojmë me seancën dëgjimore me zonjën Gjermani. Zoti Skapi do të bëjë prezantimin e parë të koleges Gjermani, më pas do të dëgjojmë kandidaten për ambasadore, zonjën Gjermani dhe pastaj do ta hapim seancën për pyetje dhe diskutime.

Zoti Skapi, fjala për ju.

Armand Skapi – E nderuar zonja kryetare,

Të nderuar deputetë,

Kam kënaqësinë të prezantoj përpara jush kandidaturën e zonjës Eglantina Gjermani për postin e Ambasadorit të Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë të Republikës së Shqipërisë pranë Misionit të OSBE-së dhe Organizatave Ndërkombëtare në Vjenë, rezident, post i cili aktualisht është vakant. Ky propozim vjen në pajtim me dispozitat e nenit 26 të ligjit nr. 23/2015 “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”.

Zonja Gjermani ka një eksperiencë të gjatë në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare, si politike, ashtu edhe akademike. Ajo u zgjedh për herë të parë deputete në parlamentin e Shqipërisë në vitin 2009 dhe u rizgjedh në vitin 2013, vit në të cilin u emërua edhe si ministre e Zhvillimit Urban dhe Turizmit. Në vitin 2015 zonja Gjermani u emërua sërish në detyrën e ministres së Zhvillimit Urban, post të cilin e mbajti deri në vitin 2017.

Gjatë mandatit të parë të saj si deputete zonja Gjermani ka qenë anëtare e Komisionit për Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë. Në vitet 2017-2021 zonja Gjermani, në cilësinë

deputetes së Kuvendit të Shqipërisë, ka qenë anëtare në Komisionin e Jashtëm, si dhe në Komisionin për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin. Ajo drejtoi për 4 vjet nënkomisionin parlamentar të Barazisë Gjinore dhe Parandalimit të Dhunës ndaj Gruas. Në vitet 2013-2017 zonja Gjermani ka ushtruar detyrën e kryetares së delegacionit parlamentar shqiptar në nismën e Europës Qendrore. Gjithashtu, në vitet 2019-2021 ajo ka qenë anëtare e delegacionit shqiptar në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Europës. Në këtë periudhë zonja Gjermani është zgjedhur edhe si raportuese në lidhje me çështjen e rritjes së pjesëmarrjes së grave nga grupet e nënpërfaqësuar në vendimmarrjet politike dhe publike, të miratuar në qershor 2021 nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Europës. Po ashtu, ajo u zgjodh si kryetare e nënkomisionit për Barazinë Gjinore në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Europës për periudhën 1 janar – shtator 2021.

Në aspektin akademik, nga viti 1995 deri në vitin 2008 zonja Gjermani ka qenë lektore me kohë të plotë në Departamentin e Punëve Sociale në Fakultetin e Shkencave Sociale në Universitetin e Tiranës, kurse nga viti 2009 e në vazhdim ajo është pedagoge e jashtme pranë këtij departamenti. Gjithashtu, gjatë vitit 2021 ka qenë pedagoge me kohë të pjesshme në Universitetin e Karolinës, Shkolla e Lidërshtpit, John Wesley, SHBA.

Në vitin 2015 zonja Gjermani mori titullin “Profesore e Asociuar” në Fakultetin e Shkencave Sociale të Universitetit të Tiranës. Titullin “Doktor në punë sociale” e fitoi në vitin 2005 në të njëjtin universitet. Ajo u diplomua me gradën “master në punë sociale” në vitin 1998 në *Grand Valley State University* në Michigan. Studimet pasuniversitare në punë sociale i kreu në vitet 1994-1995 në Fakultetin e Punëve Sociale, ndërsa studimet bachelor në degën Histori në Fakultetin e Histori-Filologjisë të Universitetit të Tiranës, diplomuar në vitin 1990.

Para se të bëhej pjesë e politikës, zonja Gjermani është angazhuar në shoqërinë civile, kryesisht në fushën e të drejtave të njeriut, të drejtave të grave dhe barazisë gjinore.

Për një periudhë dhjetëvjeçare ajo ka qenë drejtore Ekzekutive e Qendrës Aleanca Gjinore për Zhvillim, një organizatë e shoqërisë civile e fokusuar në promovimin e të drejtave të grave dhe barazisë gjinore. Gjithashtu, zonja Gjermani është autore dhe bashkautore e një sërë artikujsh, studimesh dhe publikimesh kryesisht në çështje si ato për të drejtat e grave dhe fuqizimi i tyre, integrimi gjinor në politika e programe, barazia gjinore dhe lidhja e saj me zhvillimin social-ekonomik të vendit. Ajo ka një përvojë të gjatë dhe ekspertizë në çështjet e integritit gjinor, në politika e strategji, zhvillimin e qëndrueshëm, lidërshtpit dhe mirëqeverisje.

Të nderuar deputetë,

Qeveria shqiptare i kushton një rëndësi të veçantë përfaqësimit aktiv në OSBE. Dëshmi e kësaj ka qenë kryesimi i suksesshëm i kësaj organizate gjatë vitit 2020 dhe po kështu pjesëmarrja aktive si anëtare e Trojkës, duke kryesuar gjatë vitit 2021 partneritetin e OSBE-së me vendet aziatike.

OSBE-ja e ushtron aktivitetin e saj në mbështetje të bashkëpunimit të vendeve anëtare në fushën e sigurisë përmes tre dimensioneve, politik-ushtarak, ekonomik dhe mjedisor, si dhe në dimensionin e të drejtave të njeriut. Në lidhje me dimensionin e tretë, OSBE-ja është e angazhuar të nxisë dhe mbështes zbatimin e rezolutave të Këshillit të Sigurimit të OKB-së për gratë, paqen dhe sigurinë në rajonin e OSBE-së. Në këto rezoluta njihet rëndësia e përfaqësimit të plotë dhe të barabartë të grave në organet vendimmarrëse të të gjitha niveleve për çështjet e paqes dhe sigurisë. Këto rezoluta, gjithashtu, bëjnë thirrje për marrjen e masave të posaçme për të mbrojtur gratë dhe vajzat e dhunuara mbi baza gjinore në situatat e konflikteve të armatosura.

Përveç kësaj, OSBE-ja nxit angazhimin e grave në parandalimin e konflikteve, menaxhimin e krizave dhe rivendosjen e stabilitetit pas konflikteve. Një program i posaçëm i OSBE-së për çështjet gjinore synon zhvillimin e masave për përfshirjen e grave në parandalimin e konflikteve, procesin e dialogimit, negocimit dhe arritjes së paqes në rajonin e OSBE-së.

Në propozimin e kandidaturës së zonjës Gjermani për detyrën e Ambasadorit të Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë të Republikës së Shqipërisë pranë OSBE-së dhe Organizatave Ndërkombëtare në Vjenë kemi vlerësuar pikërisht cilësitë profesionale, integritetin dhe eksperiencën e saj, sidomos në fushën e të drejtave të njeriut dhe në barazinë gjinore, të cilat janë të domosdoshme për këtë post të rëndësishëm diplomatik.

Gjithashtu, Zonja Gjermani do të jetë, në rast dekretimi, përfaqësuese e përhershme e Republikës së Shqipërisë pranë disa agjencive të specializuara të Kombeve të Bashkuara me seli në Vjenë, si Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë Atomike, Organizata e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim Industrial, Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogërat dhe Krimet apo Organizata e Traktatit për Ndalimin e Testimit Nuklear Gjithëpërfshirës.

Në përfundim, shpreh bindjen në emër të institucionit që përfaqësoj se kandidatura e zonjës Gjermani për këtë post plotëson të gjitha kriteret dhe pritshmëritë për një performancë të suksesshme në funksion të realizimit të objektivave të politikës së jashtme dhe në diplomaci shumëpalëshe dhe veçanërisht në raport me OSBE-në dhe organizatat ndërkombëtare me seli në Vjenë.

Faleminderit!

Mimi Kodheli - Faleminderit, zoti Skapi!

E vlerësoj prezantimin tuaj.

Më lejen tuaj, ia kaloj fjalën koleges Gjermani për të prezantuar para nesh atë që do të jetë risia në pozicionin që do të ketë pas dekretimit të Presidentit.

Eglantina Gjermani – Shumë faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuar deputetë,

Ju falenderoj shumë për mundësinë që më dhatë për të komunikuar me ju në këtë seancë dëgjimore! E di që është ditë e ngarkuar, ndaj e vlerësoj më shumë që jeni këtu. Dua të falenderoj zotin Skapi për prezantimin dhe gjithë konsideratat!

Gjithashtu, dua të falenderoj që në krye të herës Kryeministrin Rama dhe ministren Xhaçka për besimin dhe vlerësimin e ofruar për të shërbyer si ambasadore pranë Misionit të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë dhe Organizatave Ndërkombëtare në Vjenë!

Konteksti në të cilin ndodhemi, për sa i përket profilit dhe reputacionit të Shqipërisë në nivel ndërkombëtar, unë e konsideroj të shkëlqyer. Prej janarit të vitit 2022 Shqipëria po shërben për herë të parë si anëtare jo e përhershme e Këshillit të Sigurimit për periudhën 2022-2023. Kjo është një arritje historike për Shqipërinë. Puna ka filluar mbarë, me shumë përkushtim dhe profesionalizëm nga i gjithë ekipi i përzgjedhur. Ndërkohë, para 2 vjetësh Shqipëria kryesoi me shumë sukses OSBE-në.

Për sa i përket kontekstit global, realiteti që po jetojmë është shumë kompleks, me situata dhe sfida, kurse për sa i përket sigurisë në kuptimin më të gjerë të saj, ky realitet është vërtet i sfiduar. Shikojmë që është rritur pasiguria dhe paqëndrueshmëria në hapësirën e OSBE-së. Pa dyshim që vëmendja është përqendruar në Ukrainë dhe rreth saj, sepse kriza në/dhe rreth Ukrainës është sfida më urgjente e sigurisë në Europë.

Situata konflikti apo parakonflikti ka edhe në zona të tjera, ndaj roli dhe kontributi i OSBE-së marrin rëndësi të veçantë për ruajtjen e paqes dhe sigurisë përmes dialogut, duke respektuar parimet dhe angazhimet e aktit final të Helsinkit, si parimet themelore të kësaj organizate.

OSBE-ja është krijuar si një platformë gjithëpërfshirëse për dialog, prandaj dialogu dhe bashkëpunimi shumëpalësh tani janë më të nevojshëm se kurrë. OSBE-ja, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë, me 57 shtete pjesëmarrëse nga Europa, Azia Qendrore dhe Amerika e Veriut është organizata ndërqeveritare më e madhe rajonale për sigurinë në botë, është një forum për dialog politik me një mandat të gjerë, që përfshin një gamë çështjesh të sigurisë, që përfshin dimensionet politike - ushtarake, ekonomike dhe mjedisore,

si dhe të drejtat e njeriut, është një platformë për veprim të përbashkët për të përmirësuar jetën e individëve dhe komuniteteve. Kjo organizatë trajton çështje me ndikim në sigurinë tonë të përbashkët, si kontrolli i armëve, terrorizmi, mirëqeverisja, siguria energjetike, trafikimi i personave, demokratizimi, liria e medias dhe pakicat kombëtare.

Për sa i përket rolit të Shqipërisë dhe pjesëmarrjes së saj në OSBE, rrugëtimi i Shqipërisë në OSBE është padyshim një histori suksesi. Shqipëria u bë pjesë e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë gjatë procesit të Këshillit Ministror të Berlinit në vitin 1991. Në 31 vjet anëtarësim vendi ynë ka bërë një rrugë të gjatë në gjirin e kësaj organizate, duke kulmuar me marrjen e Presidencës në vitin 2020. Rritja e rolit dhe profilit të Shqipërisë në rajon dhe në arenën ndërkombëtare ka ndikuar në ndryshimin rrënjësor të marrëdhënieve të OSBE-së. Shqipëria nuk është vetëm konsumatore e ekspertizës së OSBE-së, por kontribuon në mënyrë të qenësishme në ruajtjen dhe nxitjen e rolit të organizatës në arkitekturën e sigurisë në Europë.

Shqipëria, megjithëse një shtet i vogël, me histori dhe sfida të mëdha, ka përfituar forcë dhe stabilitet të jashtëzakonshëm nga të qenit pjesë e këtij komuniteti të sigurisë bazuar në vlera të përbashkëta. Gjatë gjithë këtyre viteve, Shqipëria dhe kontributi i saj janë rritur dhe forcuar përmes angazhimit dhe rolit proaktiv në ndërtimin e paqes dhe stabilitetit në rajon dhe më gjerë. Marrja e kryesisë së OSBE-së në vitin 2020 ishte moment historik për Shqipërinë. Kryesimi i OSBE-së shënoi jo vetëm një arritje të rëndësishme për vendin tonë, por i dha mundësi Shqipërisë të shpalosë vlerat, frymën e paqes, dialogut dhe stabilitetit, vlera të cilat kanë qenë dhe janë pjesë e rëndësishme e politikës sonë të jashtme.

Kryesia e radhës e OSBE-së për Shqipërinë kulmoi me takimin e Këshillit Ministror në Tiranë në dhjetor të vitit 2020 dhe prodhoi dokumente të pasura në numër dhe substancë, 11 në tërësi dhe në të gjitha dimensionet. Më e rëndësishmja e këtij ministeriali ishte se 57 shtetet pjesëmarrëse ranë dakord për emërimin e sekretarit të ri të Përgjithshëm dhe drejtuesve të institucioneve të pavarura, gjë që i dha organizatës lidhshpini e lartë që i nevojitet në periudhën përkatëse sfiduese.

Gjej rastin të falenderoj ambasadorin Igli Hasani, taskforcën dhe të gjithë ekipin e Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme që punuan fort dhe realizuan me shumë sukses këtë kryesim, me gjithë sfidat e panumërta të vitit 2020!

Të nderuar deputetë,

Për sa i përket mandatit të përfaqësuesit të përhershëm të Shqipërisë pranë OSBE-së dhe organizatave të tjera ndërkombëtare në Vjenë, përfshihen dy dimensione të rëndësishme;

i pari përfaqësimi në OSBE dhe i dyti përfaqësimi në organizatat e tjera ndërkombëtare në Vjenë.

Për sa i përket vizionit dhe prioriteteve për përfaqësimin e Shqipërisë në OSBE, do të ndaj me ju disa nga prioritetet dhe fushat ku do të fokusohet puna e misionit pranë OSBE-së.

Dua ta filloj me vijimin e punës bazuar në përfaqësimin dhe punën e deritanishme dhe veçanërisht në gjithçka që u arrit me shumë përkushtim gjatë kryesimit të OSBE-së nga Shqipëria. Ndërkohë, do të vijoj puna për promovimin e Shqipërisë si anëtare jo e përhershme në Këshillin e Sigurimit për vitin 2022-2023, si dhe prioriteteve të Shqipërisë në këto cilësi. Përfshirja e këtyre prioriteteve edhe në agjendën e OSBE-së do të krijojë sinergji dhe angazhim të përbashkët për siguri dhe zhvillim të qëndrueshëm.

Këtu dua të theksoj një nga prioritetet kryesore, që u përmend edhe nga zoti Skapi, për sa i përket Shqipërisë si anëtare jo e përhershme në Këshillin e Sigurimit, që është gratë, paqja dhe siguria, që megjithëse ka qenë temë prioritare edhe në kryesimin e OSBE-së nga Shqipëria, sërish mbetet në vëmendje për shkak të rolit të grave në parandalimin e konflikteve, në ruajtjen dhe ndërtimin e paqes dhe sigurisë kudo në botë.

Shqipëria, si një vend anëtar i NATO-s dhe aspirant për t'u bërë pjesë e Bashkimit Europian, ka luajtur dhe luan një rol të rëndësishëm në ndërtimin dhe ruajtjen e paqes dhe sigurisë. Ky rol do të vazhdojë të mbetet prioritar në punën e misionit pranë OSBE-së përmes forcimit të dialogut dhe bashkëpunimit me shtetet anëtare përmes politikave paqeruajtëse dhe paqëndruese, politikave të çarmatimit dhe përdorimit të instrumenteve llogaridhënëse.

Dëshiroj të ndalem në aspektet kryesore.

I pari është kontributi në shërbim të çështjeve të sigurisë në përputhje me vlerat, parimet dhe përparësitë e politikës së jashtme të Republikës së Shqipërisë, që përfshijnë dimensionin politik-ushtarak, dimensionin ekonomik e mjedisor, si dhe dimensionin njerëzor. Gjithashtu, për çështje të tjera të lidhura me sigurinë, si fusha prioritare do të përmendja sërish agjendën “gratë, paqja dhe siguria”, respektimi i të drejtave të njeriut, klima dhe siguria, të cilat janë edhe prioritetet tona si vend anëtar jo i përhershëm në Këshillin e Sigurimit.

Gjithashtu, fusha të tjera janë parandalimi dhe zgjidhja e konflikteve, lufta kundër ekstremizmit të dhunshëm, zgjedhjet demokratike si bazë e mirëqeverisjes, mirëqeverisja, sundimi i ligjit, aktivitetet ekonomike, toleranca dhe mosdiskriminimi, trafikimi i qenieve njerëzore, siguria kibernetike, objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm.

I dyti është rritja e profilit, vizibilitetit dhe peshës së Shqipërisë në arenën ndërkombëtare, si një aktor serioz, i përgjegjshëm dhe i besueshëm, përmes përfaqësimit sa

më të denjë dhe profesional në OSBE dhe organizatat e tjera ndërkombëtare në Vjenë, angazhimit aktiv në organet vendimmarrëse, strukturat dhe mekanizmat përkatëse të OSBE-së, adresimit në mënyrë sa më proaktive dhe bashkëpunuese të çështjeve dhe tematikave që lidhen drejtpërdrejt ose tërthorazi me përparësi të OSBE-së, pjesëmarrjes aktive në organet vendimmarrëse, strukturat ekzekutive, forume dhe aktivitete, pjesëmarrjes në veprimtari të organizatës sipas tematikave, ndjekjes së angazhimit në çështjet urgjente dhe të rëndësishme të sigurisë ndërkombëtare, si dhe çështjeve tematike të lidhura me sigurinë dhe paqen.

Drejtimi tjetër është fokusimi në çështjet ku Shqipëria mund të ofrojë diçka nga përvoja dhe burimet e saj, veçanërisht në rajone dhe tematika të lidhura ngushtë me interesat e saj strategjike të sigurisë. Këtu përfshihen edhe çështje të sigurisë rajonale, europiane, që janë në agjendën e OSBE-së, si dhe vëmendje dhe angazhim mbi tematika të tjera të rëndësishme për vendin dhe partnerët, si forcimi i pozicionit të Republikës së Kosovës në arenën ndërkombëtare, forcimi i bashkëpunimit me organizatën për çështje në interes dhe zbatimin e projekteve në nivel kombëtar sipas prioriteteve tona, forcimi i marrëdhënieve me shtetet pjesëmarrëse të organizatës, bashkëpunimi i ngushtë me vendet aleate dhe partnerët strategjikë, nxitja e bashkëpunimit me organizatat ndërkombëtare dhe rajonale, siç janë Kombet e Bashkuara, Bashkimi European dhe Këshilli i Europës.

Disa nga këto prioritete, në qoftë se më lejoni, mund edhe t'i ilustroj.

Shqipëria ka qenë e angazhuar dhe gjithmonë do të punojë ngushtë me vendet e tjera, sidomos vendet aleate vendimmarrëse, në një proces që synon të rrisë efikasitetin, marrëdhënien, transparencën dhe vendimmarrjen e OSBE-së, duke përdorur sa më mirë mjetet dhe rrjetin e zyrave të OSBE-së në terren. Nxitja e forcimit të bashkëpunimit mes shteteve anëtare të OSBE-së në rrafshin e zhvillimit ekonomik, mjedisor dhe infrastrukturor do të vazhdojë të mbetet pjesë e rëndësishme e punës së Misionit. Forcimi i instrumenteve lidhur me shtetin e së drejtës, sundimin e ligjit, të drejtat e njeriut në çdo shtet anëtar të OSBE-së, duke siguruar në radhë të parë zgjedhje të lira dhe të ndershme, të drejtën e votës dhe barazinë e saj, do të jenë fusha ku Shqipëria do të vazhdojë të kontribuojë në mënyrë aktive.

Zgjerimi i bashkëpunimit me institucionet e specializuara të OSBE-së si ODIHR-i, përfaqësuesi për lirinë e medias, si dhe Komisioneri i Lartë për Pakicat Kombëtare do të jenë prioritare në vazhdimësinë e punës së misionit, duke synuar respektimin e të drejtave të njeriut në shtetet anëtare të OSBE-së.

Forcimi i rolit të misionit tonë për respektimin e të drejtave të shqiptarëve, kryesisht në Ballkan, por edhe kudo që jetojnë shqiptarë, do të vazhdojë të jetë fokus i rëndësishëm i

punës së misionit. Puna do të konsistojë në promovimin dhe respektimin e të drejtave të shqiptarëve, si e drejta e përfaqësimit, respektimit të simboleve kombëtare, e drejta e mësimit të gjuhës shqipe në shkolla dhe e përdorimit të gjuhës shqipe në institucione, e drejta e zhvillimit të rajoneve ku banojnë e të tjera. Padyshim, vëmendje dhe përkujdesje të veçantë do të kemi për shqiptarët që jetojnë në Luginën e Preshevës, respektimin e të drejtave të tyre, do të punohet për të penguar procesin e çregjistrimit dhe për të mos lejuar shpopullimin e kësaj zone nga shqiptarët.

Një tjetër prioritet i Misionit do të vazhdojë të jetë puna që institucionet e zgjedhura të Kosovës të jenë pjesë e forumeve apo tryezave ku diskutohen çështje që lidhen me zhvillimin e demokracisë, zhvillimet ekonomike e sociale të Republikës së Kosovës. Konkretisht, do të shikohen mundësitë për të zgjeruar bashkëpunimin e krijuar mes shteteve anëtare dhe institucioneve të Kosovës, ndërkohë që do të vijojë puna e nisur me shtetet anëtare të OSBE-së për anëtarësimin e Kosovës në OSBE.

Dua të ndalem pak edhe tek Asambleja Parlamentare e OSBE-së, që është dimension i parlamentar i OSBE-së. Detyra kryesore e kësaj asambleje është lehtësimi i dialogut, si një aspekt i rëndësishëm i përpjekjeve të përgjithshme për të përmbushur sfidat e demokracisë.

Asamblenë Parlamentare të OSBE-së e konsideroj edhe si një mundësi tjetër për të thelluar bashkëpunimin me parlamentin e Shqipërisë. Përfitoj nga rasti të vlerësoj angazhimin dhe kontributin e rëndësishëm të delegacioneve të mëparshme parlamentare dhe të theksoj se përmes angazhimit të delegacionit parlamentar nga Shqipëria dhe rolit aktiv në Asamblenë Parlamentare, vazhdohet të thellohet bashkëpunimi dhe marrëdhëniet e mira me shtetet anëtare.

Vëmendje të shtuar do të ketë nga misioni i Shqipërisë në OSBE edhe për programet zhvillimore që prania e OSBE-së në Shqipëri realizon, duke synuar koordinim sa më të mirë të punës.

Një aspekt tjetër është bashkëpunimi me agjencitë e Kombeve të Bashkuara në Vjenë. Misioni i Shqipërisë në Vjenë luan një rol aktiv në bashkëpunimin me të gjitha agjencitë e Kombeve të Bashkuara që ndodhen në Vjenë. Do të përmendja këtu Organizatën e Kombeve të Bashkuara, që trajton çështjet e drogës dhe krimit, Agjencinë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike, Organizatën e Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin Industrial e të tjera. Spektri i veprimtarisë së tyre është i gjerë, por që lidhet në një formë ose tjetër me sigurinë, stabilitetin, paqen dhe prosperitetin.

Me këto agjenci vazhdon bashkëpunimi me institucionet respektive në Shqipëri dhe do të vijojë puna që ky bashkëpunim të rritet dhe forcohet. Ky bashkëpunim bëhet më evident

dhe përmbajtësor me kontributin dhe rolin që Shqipëria po luan në Këshillin e Sigurimit si anëtare jo e përhershme për periudhën 2022-2023.

Të nderuar deputetë, ju kërkoj ndjesë që u zgjata. Në përmbyllje të fjalës sime dua të theksoj se Shqipëria ka pasur dhe vijon të ketë mbështetje dhe bashkëpunim me OSBE-në gjatë këtyre viteve, duke u fokusuar në fushat më prioritare për vendin, të cilat kontribuojnë në zhvillimin e demokracisë, respektimin e të drejtave të njeriut dhe në shtetin e së drejtës.

Pa dyshim, gjithë këto që thashë dhe gjithçka që është arritur deri tani, e bëjnë më të lehtë dhe më të vështirë detyrën time. Në qoftë se do të dekretohem nga Presidenti i Republikës, them se do të ma bëjnë më të lehtë, se vlerësimi për Shqipërinë, për rolin dhe kontributin e saj është folur së tepërmi në nivel global, ndërkohë e bëjnë më të vështirë, sepse standardi i përfaqësimit është rritur dhe përmirësuar ndër vite. Ndaj, duhet punuar më fort për pjesëmarrje dhe rol aktiv në përfaqësimin sa më dinjitoz dhe vizibilitetin në rritje për Shqipërinë.

Përkushtimi, përgjegjshmëria dhe puna ime do të jenë maksimale, për të thelluar bashkëpunimin me organizatën e OSBE-së, në pjesëmarrje aktive, në forume edhe me shtetet anëtare të saj. Rritja e profilit të Shqipërisë dhe rolit aktiv të saj në OSBE, por edhe në organizatat e tjera ndërkombëtare, do të jenë fokusi i punës dhe misionit tim në Vjenë.

Ju falënderoj shumë për vëmendjen!

Ndjesë edhe një herë, që u zgjata!

E vlerësoj kohën tuaj, jam e hapur për pyetje.

Mimi Kodheli – Faleminderit, kolege Gjermani!

Faleminderit, Eglantina!

Është kënaqësi të të kemi këtu dhe realisht të dëgjojmë se cila do të ishte perspektiva e angazhimit tuaj në pozicionin e ri të Ambasadorit të Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë të Shqipërisë pranë misionit të OSBE-së dhe organizatave të tjera ndërkombëtare në Vjenë. Realisht e vlerësoj prezencën tuaj dhe gjithçka që u tha deri në këtë moment.

Ju ftoj kolegë të bëni pyetje apo të jepni një koment, cilido qoftë ai.

Zoti Krashi, fjala për ju.

Lavdërim Krashi – Duke ju falënderuar sinqerisht për prezantimin shumë komprehensiv që bëtë, sidomos në lidhje me çështjen e Kosovës, duke pasur parasysh që Kosova nuk është anëtare e OSBE-së, dua të di, çfarë roli mund të keni ju si Ambasadore e Jashtëzakonshme dhe Fuqiplotë e Shqipërisë në Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim Europian? Kjo në lidhje me zgjedhjet që bëhen në Kosovë, për qytetarët serbë, të cilët jetojnë atje. Pra, për zgjedhjet që organizohen nga OSBE-ja, a mendoni se mund të kontribuoni në

këtë detyrë, që roli i OSBE-së të zvogëlohet dhe qytetarët serbë që jetojnë në Kosovë, t'i mbajnë zgjedhjet në çdo vend tjetër, duke respektuar institucionet e Kosovës në këtë rast?

Mimi Kodheli – Mirë, mbledhim edhe ndonjë pyetje tjetër nëse ka dhe pastaj ia japim fjalën zonjës Gjermani.

Po, zoti Dule.

Vangjel Dule – Unë kam një koment të shkurtër. Në radhë të parë dua të shpreh respektin më të madh dhe vlerësimet më të mira për zonjën Gjermani, si kolege deputete prej shumë vitesh.

Besoj se si te pjesa politike, ashtu edhe te ne të tjerët, keni lënë imazhin e një njeriu serioz dhe skrupuloz në çdo përgjegjësi që keni marrë.

Në aspektin e dytë, që nuk lidhet me zonjën Gjermani, dëshiroj t'i mëshoj faktit se ne nuk duhet thjesht të jemi konsumatorët të vlerave të krijuara nga OSBE-ja, por duhet të jemi edhe kontribues. Veçse për të qenë pozicionuar saktë në këtë ekuacion, duhet të kemi parasysh se ne jemi një vend problematik. Ne diktohem në OSBE si vendi që ende nuk kemi arritur të organizojmë zgjedhje të lira, të ndershme, demokratike, me rezultate të gjithëpranuara, pra nuk jemi një vend që jemi jashtë kritikave të forta dhe të herëpashershme për lirinë e shtypit, për liritë civile, për të drejtat e minoriteteve. Rrjedhimisht, besoj, do ta theksoj këtë, edhe në praninë e zotit Skapi, që për ta bërë më të lehtë misionin e zonjës Gjermani në postin e ambasadores, duhet t'u kushtojmë vëmendje këtyre aspekteve, por edhe ne si Komision i Politikës së Jashtme, sepse nuk mund të pretendosh një rol rajonal edhe më gjerë, në një kohë që je problematik në oborrin tënd të ngushtë.

Ju faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, kolegu Dule!

Ka ndonjë koment tjetër?

Doktor, fjala për ju.

Tritan Shehu - Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit, zonja Gjermani për paraqitjen tuaj!

Ne njihemi bashkë prej kohësh dhe unë nuk kam objeksione për ju personalisht, për aktivitetin tuaj, për CV-në tuaj, për punën tuaj, pasi ruaj respekt për atë që keni bërë dhe jam i bindur se do e bëni mirë në ardhmen, një punë kaq të rëndësishme siç është ajo e Ambasadorit të Shqipërisë në OSBE.

Rezervat i kam për politikën e jashtme, për Ministrinë e Jashtme, pikërisht në organizimin e trupit diplomatik, që pa dyshim nuk mund të mos prekë edhe emërimet e ambasadorëve në tërësi, jo vetëm për zonjën Gjermani, për të cilën unë kam vetëm një

objeksion nga ato që tha. Ju thatë se reputacioni i Shqipërisë në botë është i shkëlqyer. Po të jetë i shkëlqyer, unë besoj se edhe ambasadori i Zvicrës nuk do të guxonte të thoshte një gjë të tillë për Zvicrën, jo më ai i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, se po të ishte kaq i shkëlqyer, pastaj, ku do të ishte roli juaj dhe roli ynë?

Në fund të paraqitjes suaj ishit realiste, duke treguar përparësitë dhe detyrat tuaja, ato që duhen përmirësuar dhe që duhen zhvilluar, se ky është realitetet. Këtë jua them me shumë bonsens.

Në lidhje me paraqitjen që bëri zoti sekretar i Përgjithshëm, i cili iu referua ligjit të shërbimit të jashtëm të vitit 2015, dua të them se këtu fillojnë edhe problemet e trupit tonë diplomatik, me politizim e tij, me partizimin ekstrem të tij, duke u hedhur në erë edhe parimi i 20%-shit, që ishte dikur, duke bërë që ne të mos marrim më të mirët që kemi në shërbimin diplomatik, por të marrin në trupin diplomatik të tjerë që nuk kanë lidhje me të. Këtu nuk e kam fjalën për zonjën Gjermani, pasi ajo ka një karrierë të pasur politike, sociale, ministeriale, parlamentare, por e kam fjalën në tërësi, se ajo që përmenda më lart bën të hidhen në erë elemente të karrierës, elementet e asaj që aspiron çdo pjesëtar i trupit diplomatik, sepse në fund të fundit çdo pjesëtar i trupit diplomatik aspiron të bëhet ambasador dhe kjo është normale, sepse në të gjithë botën kështu funksionon.

Ju me politikat tuaja e keni shkatërruar këtë gjë. Ju me politikat tuaja keni bërë që ne sot nga rreth 50 ambasadorë që ka Shqipëria, 20 ose 30 prej janë jashtë mandatit të tyre. Vetëm Afrika i ka këto standarde me mënyrën e qëndrimi të ambasadorëve në vendet përkatëse larg afatit kohor të tyre.

Bëni mirë që flisni, që emëroni menjëherë një figurë në OSBE, por nga ana tjetër dua t'ju them se keni 8 vjet që s'keni ambasador në Selinë e Shenjtë. Ky është skandal i vërtetë. Ky është një skandal i paimagjinueshëm.

(Kryetarja e komisionit Mimi Kodheli ndërhyr pa mikrofon.)

Se çfarë dua të flas, e di unë, zonja kryetare. E di unë sesi i bëj komentet, ju nuk keni të drejtë të ndërhyni në fjalën e një deputeti.

(Kryetarja e komisionit Mimi Kodheli ndërhyr pa mikrofon.)

Ju lutem, e di që ka shumë foltore. Zonja kryetare, këtu po flas unë.

Ju lutem, mbani qetësi kur flas unë.

(Kryetarja e komisionit Mimi Kodheli ndërhyr pa mikrofon.)

Se dua unë, ja pse, vetëm për këtë arsye.

Unë flas, ti më ndërhy kur flas, kjo është pa edukatë.

Pra, në këtë mënyrë unë mendoj se ju cenoni trupin diplomatik shqiptar, prandaj mendoj se gjërat duhen parë më gjerë, jo thjesht për një person që emërohet në një ambasadë, por në tërësi të përbërjes së trupit diplomatik shqiptar, se kjo është e rëndësishme. Prandaj mendoj se këto janë elemente që mund t'i diskutojmë edhe një njëherë tjetër së bashku këtu, jo sot. Jam dakord që nuk është vendi sot për të hapur këto debate, por meqenëse ne caktojmë një ambasador, pavarësisht se unë nuk kam objeksione për këtë person, për postin e tij, dua ta theksoj përsëri, se kam objeksione të mëdha për politikën tuaj si Ministri e Jashtme, ndaj trupit diplomatik, ndaj emërimit të ambasadorëve, ndaj mënyrës së përzgjedhjes, ndaj mënyrës së eficiencës së tyre, pasi edhe shumica e ambasadorëve janë jashtë mandatit të tyre. Kjo tregon një gjendje katastrofike për një vend. E thashë, vetëm Afrika është e pasur me këtë praktikë.

Këto kisha.

Faleminderit!

Mimi Kodheli - Faleminderit!

Po, zoti Koçi fjala për ju.

Petro Koçi – Faleminderit, zonja kryetare!

Së pari, dua të falënderoj kandidaten për ambasadore pranë misionit tonë në OSBE, për prezantimit!

Së dyti, i bashkohem vlerësim të zotit Dule, rreth kandidaturës, pasi bëhet fjalë për një kandidatë me një integritet të plotë moral, shoqëruar me një përvojë të jashtëzakonshme jo vetëm politike dhe parlamentare, por edhe akademike.

Sigurisht, në kohët që po përjetojmë, duket sikur është koha e gjeneralëve, për shkak të sfidave ndaj sigurisë brenda territorit të OSBE-së dhe këtu e kam fjalën për Ukrainën dhe zonat përreth saj, po pse jo, edhe për zhvillime sfidante në Bosnjë – Hercegovinë apo diku tjetër.

Megjithatë, Shqipëria ka vendosur të dërgojë pranë OSBE-së një simbol të paqes. Më vjen shumë mirë për këtë gjë, sepse në fund të fundit, misioni i OSBE-së këtë nënkupton. Unë e vlerësoj shumë kandidaturën e zonjës Gjermani. Mendoj se kritikën e zotit Shehu duhet t'i drejtohen ministrisë në nivelin politik, as kandidatës dhe as sekretarit të Përgjithshëm, ndoshta mund të na i drejtojë neve si maxhorancë, pasi është një këndvështrim i lirë opozitar dhe mendoj se ka nevojë të artikulohet.

E kam fjalën që drejtimi i kamerës politike ishte i gabuar, pastaj qëndrimi politik është i pavarur dhe e vlerësoj, sepse e ngacmon gjithmonë debatin edhe na zhvillon të gjitha

mundësitë për të parë më gjera sesa shohim normalisht. Unë e vlerësoj shumë rolin e opozitës.

Në fund dua të them se sot jemi në një seancë, e cila na bashkon në një vlerësim pozitiv të gjithëve, pavarësisht nga pozicionet politike dhe partiake. Kuptohet, politika e jashtme përgjithësisht zhvillohet në disa kolona, që përgjithësisht partitë nuk guxojnë t'i prekin shumë, pavarësisht se një qeveri ndryshon nga një tjetër, por siç e thashë, kolonat e politikës së jashtme nuk ndryshohen.

Unë besoj se marrëdhëniet dhe roli i Shqipërisë pranë OSBE-së ka ardhur në rritje. Më vjen mirë që zonja Gjermani vlerësoi ish-ambasadorin Hasani, sepse e ka drejtuar OSBE-në në një moment sfide, siç ishte ai i rolit të Shqipërisë gjatë vitit 2020. Më kujtohet, kam qenë në fillim të vjeshtës së vitit 2019 në një takim me ambasadorët e NATOS-s pranë OSBE-së, ku kishte një interes të jashtëzakonshëm për politikën e sigurisë dhe të mbrojtjes së Shqipërisë, sidomos në nivel rajonal. Mendoj se dinjiteti i Shqipërisë në politikën e jashtme fillon kryesisht nga politika e paqes dhe e bashkëpunimit në nivel rajonal, pastaj duke u ridimensionuar edhe më tej. Besoj se ky është një profil që edhe për ju do të vlejë shumë gjatë punës dhe funksionit tuaj si ambasadore, gjithmonë në rastin se Presidenti bën dekretimin e duhur.

Ju falënderoj shumë për prezantimin!

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, kolegut Koçi!

Unë mendoj që t'ia jap fjalën koleges Gjermani për t'iu përgjigjur zotit Krashi, meqenëse zoti Krashi ka një angazhim tjetër dhe duhet të largohet.

Më pas fjalën e ka zoti Idrizi dhe pastaj nënkryetari Alizoti.

Zonja Gjermani.

Eglantina Gjermani - Faleminderit, kryetare!

Së pari, kam një falënderim dhe një mirënjohje për të gjithë kolegët, për vlerësimet, për mbështetjen! U jam shumë mirënjohëse.

Lidhur me pyetjen e zotit Krashi, në fakt është një çështje që edhe unë vetë e kam diskutuar dhe e kam ndjekur, në mënyrë të vazhdueshme, pasi lidhet me zgjedhjet e lira dhe të ndershme, siç thatë ju. Besoj se puna e misionit do të jetë për të garantuar ose nxitur, që këto zgjedhje të jenë të lira edhe në atë zonë të Kosovës. Ka sfida, me sa kam diskutuar edhe me stafin e Ministrisë së Jashtme për sa i përket qasjes përfshirëse që ka OSBE-ja dhe konsensusit për të arritur atë që ne synojmë, për të siguruar zgjedhje të lira. Mendoj që

përmes dialogut me disa nga shtetet anëtare, që janë më dashamirëse dhe më mbështesë, do të arrijmë ta garantojmë këtë gjë.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, zonja Gjermani!

Zoti Idrizi.

Shpëtim Idrizi – Shumë herë edhe këtu në Komisionin e Politikës së Jashtme kemi qenë skeptikë për nivelin e prezantimit dhe të përfaqësimit të Shqipërisë në trupin diplomatik, por ky është rasti për të thënë që zonja Gjermani i bën nder përfaqësimit të Shqipërisë, akoma më shumë në OSBE, ku besoj se roli dhe sfidat janë shumë të mëdha edhe për sa u përket zgjedhjeve, por edhe për atë çka rajoni po përjeton. Ky është rasti ku unë dua të vlerësoj zonjën Gjermani, edhe si ish-kolege, pasi besoj se është kandidatura më e gjetur dhe më e duhur për të përfaqësuar Shqipërinë. Madje dua të them që, sikur t'i kishim edhe të tjetër në nivelin e zonjës Gjermani, pa dyshim do ta rrisnim shumë nivelin e përfaqësimit të Shqipërisë jashtë.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit!

E vlerësoj ndërhyrjen tuaj.

Nënkryetar Alizoti, fjala për ju.

Tomorr Alizoti – E nderuar zonjë, pas këtyre fjalëve pozitive rreth jush, unë personalisht nuk ju kam njohur nga afër, dua t'ju bëj disa pyetje të thjeshta.

Politika e jashtme, në këndvështrimin tim, nuk është diçka akademike, politika e jashtme është edhe akademike, edhe praktike. Kjo nuk ka të bëjë me ju, pasi ne jemi deputetë që përfaqësojmë një rrymë politike dhe kemi një mendim politik. Unë mendoj se në politikën e jashtme, në shtetin shqiptar, ndonjëherë diplomacia përdoret për qoka. Kjo nuk ka të bëjë me ju, mos më keqkuptoni. Pra, nëse dikush nuk bëhet pjesë e qeverisë apo nuk bëhet deputet, përfundon ambasador diku. Kjo e dëmton strukturën e politikës së jashtme dhe diplomacinë në tërësi. Me gjithë respektin për ju, e ripërsëris edhe një herë, duke marrë shkas nga fjalët e mira që dëgjoj nga zonjat dhe zotërinjtë këtu, në dijeninë time OSBE-ja është një institucion shumë i rëndësishëm. A keni ju një tezë të politikës së jashtme mbi interesat e Shqipërisë? Keni një staf, që vjen nga diplomacia, nga karriera diplomatike? Unë mendoj se nuk e keni dhe kjo nuk është për fajin tuaj, sepse diplomacia në Shqipëri, fatkeqësisht, është kthyer në një lloj qoke. Kjo e dëmton shumë politikën e jashtme shqiptare në një kohë krize botërore, siç është rasti i Ukrainë dhe i Lindjes.

Kjo nuk ka të bëjë me qeverinë tuaj, është traditë e vjetër në shtetin shqiptar, por kam përshtypjen që tani është kthyer pak si në version bërje qejfesh. Në rastin tuaj, siç dëgjoj kolegët, më vjen mirë për karrierën që keni. E para.

E dyta. OSBE-ja në vetvete ka pasur dy shtylla kryesore, njëra nga ato ka qenë e Vili Brandit, kancelar i famshëm dhe tjetra e strategut të famshëm të politikës së jashtme gjermane Egon Bahr, ku bëhej fjalë për Luftën e Ftohtë, për Murin e Berlinit. Pra, ata përpiluan një tezë që ishte ndryshimi nëpërmjet afrimit dhe nëpërmjet komunikimit.

Rikthehem edhe një herë, cilat janë planet tuaja në lidhje me situatën në Ukrainë bashkë me vendet anëtare përreth? Cilat janë planet për interesat e shqiptarëve, aq sa më mund t'i besojë OSBE-ja? Pra, brenda logjikës së OSBE-së, sepse ne jemi një vend i vogël, por politika e jashtme është mbrojtja e interesave tona, pasi ekziston një mendësi në vendin tonë dhe themi që jemi një vend i vogël. Ne jemi të vegjël, por ne përfaqësojmë veten. Pra, kur ne shkojmë jashtë, përfaqësojmë Shqipërinë, sado e vogël, sado e varfër që është. Pra, dua të di disa gjëra konkrete: si do të operoni ju?

Përfundimisht, kjo s'ka lidhje me ju, mendoj që politika e jashtme është edhe praktike, është goxha praktikë, është komunikim, është kontakt, nuk është vetëm akademi. Gjithsesi, ju do të keni shumicën dhe mendoj që kandidimi juaj do të miratohet. Shpresoj që, atë që nuk e kanë bërë të tjerët, ta bëni ju.

Mimi Kodheli – Zonja Gjermani, përpara se t'ju jap fjalën më intrigon ky komenti i fundit i nënkryetarit. Kjo që do të them është thjesht për batutë, në fakt zonja Gjermani mund të ketë udhëtuar jashtë shtetit dhe të ketë pasur “praktikë”, më shumë sesa mund të ketë pasur një ambasador në karrierën e tij. Çështja e praktikës, ishte vetëm për batutë.

Përgjigjet zonja Gjermani, pastaj kolegja Spahiu.

Eglantina Gjermani - Faleminderit, kryetare!

Sërish faleminderit, të gjithë kolegëve!

Dua ta filloj me hyrjen pak entuziaste që unë bëra, për sa i përket reputacionit të Shqipërisë, që unë e konsideroj të shkëlqyer. Për një vend të vogël si Shqipëria, të zgjidhet vend anëtar jo i përhershëm në Këshillin e Sigurimit dhe të kryesojë OSBE-në, mua më duken rritje të shkëlqyera historike, për të cilat është punuar dhe kontribuar shumë vite mbase, por më vjen mirë që i arritëm dhe i kemi realizuar ose jemi në proces e sipër. Them që janë mundësi të arta për të rritur reputacionin e Shqipërisë.

Sa i përket një shqetësimi që edhe zoti Dule përmendi, që edhe ne si vend kemi problematikat tona për të drejtën votës apo problematika të tjera, unë mendoj se vlerësimet për Shqipërinë nga OSBE-ja dhe nga organizma të tjerë ndërkombëtarë janë në rritje për

gjithçka që është bërë. Sigurisht, kemi ende sfida, se demokracia është një proces në konsolidim, por gjithë përvoja e arritur mund të ndihmojë shtetet e tjera anëtare që kanë shumë problematika për sa i përket lirisë së votës, të të drejtave të njeriut dhe të tjera me radhë. Ne nuk themi që kemi arritur, si të thuash, demokracinë në majat më të larta, siç mund të jenë vendet e zhvilluara, por mendoj që çdo arritje në këto fusha, qoftë në të drejtat e njeriut, qoftë lirinë e medias, qoftë për sa u përket zgjedhjeve të lira dhe ndershme, mendoj se janë arritje për të cilat jemi krenarë dhe kemi ende sfida për të realizuar.

Lidhur me komentin që bëri zotit Alizoti, për pjesën e karrierës diplomatike, e vlerësoj shumë edhe vlerësimin që më bëtë, edhe faktin që kjo gjë mbase nuk më drejtohej personalisht mua, por është një pyetje që pa dyshim e prisja. Përvoja ime në këto vite, 3 herë deputete, ndër to 4 vjet ministre, më ka bërë që pa dyshim të kem një përvojë në marrëdhënie ndërkombëtare diplomatike, duke përfaqësuar shtetin, duke qenë pjesë e delegacioneve parlamentare e Këshillit të Europës, duke qenë kryesuar e delegacioni të Central European Initiative, si pjesë e delegacionit parlamentar për 4 vjetët e kaluar, duke qenë konsulente e OSBE-së për gati 20 vjet në projekte dhe programe, qoftë si pjesë e politikës, qoftë edhe si shoqëri civile, duke qenë bashkëpunëtore në shumë projekte që OSBE-ja realizon në Shqipëri, si në cilësinë deputetes, ashtu edhe në cilësinë e ministres, apo edhe si përfaqësuese e shoqërisë civile.

Pa dyshim, mendoj se përvoja akademike është një aset që më ndihmon. Sigurisht që diplomacia është edhe praktikë, por unë mendoj se çdo përgjegjësi që kam marrë ka qenë sfidë për mua edhe mendoj që edhe kjo është një sfidë e bukur, interesante, ku pa dyshim edhe unë do të mësoj, siç mësohet çdo ditë, se besoj që të gjithë mësojmë. Për një gjë jam e bindur, që përvoja e ndërtuar deri tani në marrëdhëniet ndërkombëtare, në komunikim, në përfaqësimin e Shqipërisë kudo, janë, gjithashtu, një anë e fortë, mbi të cilën janë bazuar Kryeministri dhe ministrja për të më dhënë këtë mundësi për të qenë ambasadore pranë OSBE-së.

Pa dyshim që do të presim konfirmimin e Presidentit, por gjithsesi kjo është për sa i përket përvojës diplomatike.

Nga ana tjerët, sa u përket tezave për zhvillimin ose tezat e mia për rolin dhe përgjegjësinë time si ambasadore atje, mendoj që çdo gjë që është ndërtuar ndër vite nga ambasadorët pranë OSBE-së, sidomos nga kryesimi i radhës, është diçka që do të vazhdojë të ndërtohet, kjo është qasja ime, dhe mundësisht të rritet pjesa pozitive e gjithçkaje që është bërë deri tani dhe, pa dyshim, nëse ka, sfida dhe mundësi të tjera ku mund të kontribuoj, jam shumë e angazhuar për të bërë këtë gjë.

Për sa i përket rolit të shqiptarëve dhe angazhimit që do të ketë OSBE-ja për shqiptarët kudo që jetojnë, unë i përmenda pak më parë, qoftë për Kosovën, qoftë për shqiptarët që jetojnë në rajon, apo në Luginën e Preshevës, misioni do të ketë një rol proaktiv për të siguruar të drejtat, respektimin e të drejtave të tyre për zhvillimin, simbolet kombëtare, përdorimin e gjuhës, etj.

Sa i përket sigurisë, qoftë edhe për çështjen e Ukrainës, mendoj që Kryeministri, ministrja e Punëve të Jashtme, përfaqësuesit tanë në Këshillin e Sigurimit, Shqipëria, si një vend anëtar i NATO-s, por edhe si anëtare e Kombeve të Bashkuara, si aspirante për në Bashkimin Europian, si anëtare e OSBE-së, ka mbajtur qëndrime të drejtpërdrejta dhe të qarta lidhur me respektimin e integritetit territorial me sovranitetin Ukrainës, duke mbajtur një rol proaktiv për sa i përket respektimit të këtyre vlerave të përbashkëta si anëtarë të OSBE-së. Edhe një vend i vogël si ne mund të mbajë qëndrime të tilla dhe mua më duket shumë e guximshme dhe shumë e drejtë që pasqyron dhe shpalos vlerat, që kanë qenë pjesë e politikës së jashtme ndër vite në Shqipëri.

Nga përvoja ime 4-vjeçare si anëtare e Komisionit të Jashtëm, doja të përmendja që Komisionin e Jashtëm e kam parë gjithmonë si një komision, që ka kapërcyer kufijtë politikë dhe ka trajtuar gjithmonë me konsensus qasjet e OSBE-së të gjitha çështjet që janë diskutuar këtu dhe them se është model shumë i mirë bashkëpunimi.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, koleges Gjermani!

Fjalën e ka kolegja Spahiu dhe më pas kolegja Konomi.

Klodiana Spahiu – Faleminderit, kryetare!

Faleminderit Tina për të gjithë paraqitjen!

Besoj që karriera juaj politike, profesionale dhe akademike ju plotëson në të gjitha aspektet jo vetëm për të drejtuar detyrën që do të merrni, por besoj se edhe mbështetja e të gjithë kolegëve e tregon këtë. Është e vërtetë, duhet shumë mund për të gjetur figura të kompletuara nga të gjitha anët për të përfaqësuar politikën, prandaj besoj se ju jo vetëm e meritoni, por gjatë 12 vjetëve të karrierës sonë të përbashkët politike keni qenë vërtet një figurë nga e cila kam mësuar shumë, të paktën si deputete e re që kam qenë në vitin 2009, sepse ju kishit një bagazh shumë të gjerë në lidhje me pjesën tuaj profesionale, gjithmonë në mbrojtje të të drejtave të grave.

Do t'ia nis pikërisht këtu, me një nga objektivat tuaj, që ishte mbështetja e rezolutës “Gruaja, paqja dhe siguria”, për të cilën ju dhe kolegja Kodheli keni punuar shumë fort në shumë vite, po bëhen 10 vjet që nga nismat e para që janë marrë, në mbështetje të kësaj

rezolute. Besoj se ju do ta çoni më tej përpjekjen e përbashkët me të gjitha angazhimet që janë marrë edhe në Shqipëri në lidhje me këtë rezolutë. Uroj dhe shpresoj që ky bashkëpunim i ngushtë për të gjithë punën që keni bërë, përveç politikave të jashtme që duhet të drejtoni atje dhe të gjitha ato objektiva që ju theksuat, do të vazhdojë me tej bashkë me punën tuaj për mbrojtjen e të drejtave të grave në të gjitha aspektet.

Unë e vlerësoj maksimalisht gjithçka që keni bërë, si dhe për mbështetjen dhe përkrahjen që na keni dhënë në vajzave dhe grave të përfshira në politikë, duke na nxitur e duke na bashkuar të gjithave që të bëhemi pjesë e politikës, pavarësisht forcave politike që përfaqësojmë.

Edhe një herë të uroj mbarësi në punën e re pas dekretimit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, doktoreshë!

Zonja Konomi, fjala për ju.

Hatixhe Konomi – Faleminderit, kryetare!

Faleminderit shumë, zonja Gjermani, për të gjithë prezantimin!

Në fakt, un nuk kam pyetje, por dija të bëja një koment të shkurtër dhe doja ta nisja me një thënie shumë të bukur të një kongresmeneje amerikane, Shirley Chisholm: “Tani vendi ynë ka nevojë për idealizmin e grave dhe vendosmërinë e tyre, ndoshta më shumë në politike se sa në sferat e tjera”. Në fakt, me këtë thënie dua të shpreh të gjithë konsideratën time për të gjithë angazhimin tuaj në këto vite në politikë. Jam shumë e nderuar sot që ju dëgjova dhe që do të mbështes kandidaturën tuaj!

Unë, si një politikane e re, e futur rishtazi në politikë, ju kam ndjekur ndër vite, keni qenë një model frymëzimi për mua dhe mendoj se jeni një ndër modelet më të mira për t’u ndjekur në politikë, të paktën për ne politikanet e reja. Kështu që, faleminderit për kontributin tuaj ndër vite!

Mimi Kodheli - Mua më duhet t’ju falënderoj kolegë për seriozitetin dhe fjalët e mira dhe të merituarra për kandidaten, si dhe për mbështetjen që do t’i japim si komision kandidaturës së sjellë nga qeveria shqiptare.

Më lejoni të them dy fjalë në fund!

E konsideroj të domosdoshme ta bëj këtë për faktin se ministren Gjermani, siç e thërras rëndom, e konsideroj një kolege të vjetër dhe realisht dua të nënvijëztoj faktin që qeveria shqiptare i ka dhënë rëndësinë dhe vlerat e duhura këtij komisioni, duke na sjellë këtu kandidaturën e ministres Gjermani. Është shumë e rëndësishme të perceptojmë dhe të përcjellim edhe mesazhin që qeveria ka dashur të transmetojë nëpërmjet kësaj kandidature.

Thjesht për kuriozitetin e atyre që na ndjekin, më kujtohet kur një ish-kolegu im spanjoll, në kohën kur unë isha ministre e Mbrojtjes, la detyrën si ministër i Mbrojtjes i Mbretërisë së Spanjës, u dërgua ambasador në Uashington. Pra, ka disa pozicione, sidomos pozicione të konsideruara kyçe për vende apo organizata të një rëndësie të veçantë, të cilave u jepet një vlerësim tjetër, duke dërguar më së shumti dhe më së pari kandidatura, që nuk vijnë në mënyrë të domosdoshme nga karriera diplomatike, por vijnë nga karriera të tjera akademike, apo, pse jo, politike, për t'i dhënë një shtysë apo një rëndësi tjetër kësaj organizate, apo atij vendi. Besoj se, në mënyrë absolute, ky është rasti i kandidaturës së ministres Gjermani për gjithçka që u tha këtu.

OSBE-ja është një organizëm që nuk ka të bëjë vetëm me procesin zgjedhor, por, së pari, me sigurinë dhe, siç u përmend edhe këtu, Shqipëria sot ka një pozicion të rëndësishëm për vetë karriget ku ulet.

Në atë pozicion që do të shkoni, ministre, pas dekretimit të Presidentit, do të keni fatin të jeni vazhdimësi e një historie suksesi, sidomos në vitet e fundit. Në këtë rast dua të falënderoj në mënyrë të veçantë Kryeministrin Rama, asokohe ministrin Bushati dhe asokohe ambasadoren Hasani për punën e jashtëzakonshme që kanë bërë jo vetëm për marrjen e presidencës, i cili nuk është një proces i thjeshtë, por edhe për mbajtjen dhe drejtimin e OSBE-së në një periudhë të vështirë, si periudha e pandemisë, por edhe në periudhën e disa konflikteve, të cilat më pas rezultuan të ishin më shumë se konflikte. E kam fjalën për ndodhitë në kufijtë e Ukrainës dhe jo vetëm.

Të mos harrojmë se ajo që ka ndodhur këto javët e fundit, nuk është pasojë e një konflikti që zë fill muajin e fundit, por është pasojë e një konflikti të datuar herët, me të cilin është përballur OSBE-ja dhe presidenca shqiptare asokohe në mënyrë të suksesshme.

Thënë kjo, mirëpres të gjithë pozicionimin e Shqipërisë lidhur me rezolutën jo vetëm të OKB-së, por edhe të një prej objektivave kryesorë që pozicionimi i Shqipërisë në Këshillin e Sigurimit ka sot, si dhe atë që ju do të bëni në mbështetje të rezolutës “Gratë, paqja dhe siguria”, për të cilën do të vijojmë të punojmë dhe ju, zonja Gjermani, keni mbështetjen tonë sa herë të jetë e nevojshme dhe të kërkohet.

OSBE-ja është edhe kontroll armatimi, është shumëçka, pra është një organizëm ndërkombëtar, i cili me të vërtetë ka shumë punë që kanë të bëjnë me mbarëvajtjen e demokracive, me sigurinë rajonale dhe europiane e më gjerë, por sigurisht edhe me shumë çështje të ditës, me të cilat jam e bindur se do të dini të përballeni suksesshëm dhe t'u jepni zgjidhje.

Ju falënderoj edhe një herë për durimin, për përfaqësimin!

Falënderoj në mënyrë të veçantë zotin Skapi për praninë!

Ju garantoj që opinioni që do të dalë nga seanca dëgjimore për në Presidencë do të jetë ai i duhuri dhe maksimalisht pozitiv në vlerësimet tuaja.

Shpresoj të shihemi në bashkëpunimet e ardhshme dhe uroj gjithë të gjitha të mirat në detyrën tuaj të re!

Zoti Skapi shpresoj që, edhe nën vëzhgimin e kolegëve këtu, pa përmendur emra, të mund të kemi prani të tjera për kandidatura të reja, meqë jeni në proces të rinovimit të pothuajse të të gjitha përfaqësive tona në organizma ndërkombëtarë në botë.

Faleminderit!

Seancën e deklaroj të mbyllur.

Punë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA